



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË  
PROCESVERBAL**

Nr. 213/1 Prot.

Tiranë, më 13.10.2020

Sot, më datë 13.10.2020, ditën e martë, ora 11.00, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi mbledhjen plenare të radhës në platformën online, përmes lidhjes Zoom, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Këshilli u mblodh në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Z. Gent Ibrahimim
2. Z. Alfred Balla
3. Znj. Esmeralda Keshi
4. Z. Tartar Bazaj
5. Z. Bujar Sheshi
6. Z. Kosta Beluri
7. Znj. Nurihan Seiti
8. Z. Sandër Beci
9. Z. Vatë Staka

Ishin ftuar për të qenë të pranishëm përfaqësues nga projektet OPDAT, EURALIUS dhe nga Ministria e Drejtësisë.

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Gent Ibrahimimi, i cili, në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi verifikoi pjesëmarrjen e anëtarëve, bëri hapjen e saj në kushtet e kuoromit dhe kaloi në paraqitjen e rendit të ditës.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i projektvendimit “Për përllogaritjen e mandatit kushtetues si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.
2. Të tjera (pyetje, përgjigje, diskutime.).



**Z. Ibrahim** shprehet se qëllimi i kësaj mbledhjeje jashtë rradhe është që Këshilli, përmes një vendimmarjeje nga ana e tij, të sqarojë një keqkuptim, i cili ka lindur lidhur me datën e fillimit të mandatit të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ai i referohet nenit 149/b të Kushtetutës, sipas të cilës Këshilli i Lartë i Prokurorisë deklaron qoftë fillimin e mandatit, qoftë mbarimin e mandatit të anëtarëve. Këshilli do të marrë një vendim, i cili do qartësojë dhe saktësojë pikërisht këtë keqkuptim.

Pasi lexon projektvendimin, Kryetari kërkon pëlqimin e të gjithë anëtarëve të Këshillit për miratimin e tij.


**Të gjithë janë dakord. Miratohet me 9 vota pro.**

(*Vendimi i plotë gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit*).

**Z. Ibrahim** falënderon anëtarët dhe në përfundim, duke mos patur pika të tjera për diskutim, e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

#### **Mbajtësi i procesverbalit**

Sonila Çeliku

  
  
Gent Ibrahimimi

#### **Shënim:**

Në këtë procesverbal janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësitë e mundshme, të konstatuara nga anëtarët e KLP-së.

Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_ 2020/më vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ (bashkëlidhur kopjet e dokumenteve).

Procesverbal i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së, datë 15/10/2020  
Procesverbal të arkivohet.

#### **PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE**

Frederik Sulisufi